



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1085/Prot.
2

Gramsh, më 12.04.2021

V E N D I M

Nr. 51, datë 02.04.2021

MBI

MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM TË SIPËRFAQEVE
PYJORE/KULLOSORE NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH.

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 02.04.2021, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, në mbështetje të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar, bazuar në nenin 54 gërma “e” të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, në zbatim të VKM-së nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, i ndryshuar, të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 3 gërma “ç”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1/ b, neni 23/4, si dhe neni 54 gërma “k” e tij, Këshilli Bashkiak Gramsh :

V E N D O S I :

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore dhe kullor që i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Gramsh.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI

Konceptoi: Xhulia Gjini
Miratoi: Greta Lena

KRYETARI I KËSHILLIT
GRETA LENA